



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
Kuvendi - Skupština – Assembly

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja nr. 02/2009  
Më 27. 01. 2009, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Sala Berisha – Shala, Berim Ramosaj dhe Múfera Şinik.

Munguan: Slobodan Petroviq, Kaqusha Jashari dhe Zef Morina.

Pjesëmarrës të tjerë: William James dhe Haxhi Gashi nga USAID-i, Izer Arifi (Zyra Ligjore në MTI) dhe Naser Grajqevci dhe Nol Buzhala nga MTI-NVM, Hakif Jashari (zyra ligjore në MEM), Blerina Uka nga NDI, Kaltrina Ademi - nga KDI-ja, Valon Stavileci menaxher për çështje ligjore nga “Projekti-Kosova e Re”, Besim Zeqiri dhe Sagita Muço nga ICO.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 20.01.2009;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Zonat Ekonomike;
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Gazin Natyror;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve;
6. Të ndryshme;

### **I. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

### **II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 20.01.2009;**

Procesverbali i mbledhjes së datës 20 janar 2009 u miratua pa vërejtje.

### **III. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Zonat Ekonomike;**

**Kryetarja** - ua dha fjalën anëtarëve të Komisionit për shqyrtimin në parim të Projektligjit për Zonat Ekonomike.

**Haki Shatri** – theksoj se ky Projektligj ka disa vërejtje mirëpo ato do të evitohen në Grup punues, në fazën e amendamentimit, dhe njëherit u bëri thirrje deputetëve që ta miratojnë në parim.

Pas një diskutimi të gjerë, Komisioni njëzëri e nxori këtë:

#### **Përfundim**

- I. Miratohet në parim Projektligji për Zonat Ekonomike;
- II. Caktohet Haki Shatri si raportues.

### **IV. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Gazin Natyror;**

**Kryetarja** – kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i japin komentet e tyre në parim lidhur më Projektligjin për Gazin Natyror.

**Ethem Çeku** – tha se duhet edhe një here të analizohet më mirë ky Projektligj d.m.th tu kthehet ekspertëve të kësaj fushe dhe pas analizave të thukta të silltet në Kuvend. Poashtu si tha se hyrja në fuqi e këtij Projektligji e largon nga prioriteti i përcaktuar më herët Projektin “Kosovën e Re”. Krejt në fund u bëri thirrje anëtarëve të Komisionit që të shtyhet ky Projektligj.

**Kryetarja** – theksoj se në bazë të analizave që i ka bërë këtij Projektligji, është i hartuar dhe i harmonizuar në bazë të Direktivave të BE-së, dhe e cilësoj së të nevojshme përgatitjen e infrastrukturës ligjore në këtë fushë.

**Fatmir Rexhepi** – tha se ne duhet së pari të shfrytëzojmë resurset natyrore dhe të shiqohet interesi strategjik i vendit, sepse duhet të shfrytëzojmë sektorin e thëngjillit. Duke i'u referua përmbajtjes së Projektligjit në raste konkrete, tha se shiqojeni nenet 25 dhe 26, të cilët në mënyrën më të keqe të mundshme janë hartuar. Andaj në fund tha se duhet të kemi së pari debat për këtë çështje dhe mos të ngutemi me marr vendime të shpejta.

**Safete Hadergjonaj** – tha se Projektligji është hartuar nga ekspertët e qeverisë pas studimeve të bëra mirë. Mirëpo edhe pse ka mangësi në raste të caktuara, ajo tha se në fazën e amendamentimit mund të evitohen, mund të thërrasim ekspert tjerë, të

organizojmë dëgjime publike, në mënyrë që të del në fund një ligj shumë i mirë. Ajo u sugjeroj anëtarëve të Komisionit që të mos i japin Projektligjit konotacion politik dhe nga frika e GAZPROM-it, për të mos e miratuar në parim sepse në fund të fundit këtë Projektligj e kërkon edhe vet Traktati i Energjisë. Pra ishte për miratim në parim të Projektligjit për Gazin Natyror.

**Sala Berisha – Shala** – tha se nuk është detyrë e Komisionit që të behet prolongimi i Projektligjeve, por amendamenti dhe miratimi i tyre. Gjithashtu ajo tha se më miratimin e këtij Projektligji nuk dëmtohen në asnjë mënyrë resurset e vendit, andaj kërkoj nga Komisioni që të miratohet në parim Projektligji për Gazin Natyror dhe pastaj në Grup punues të shtjellohen të gjitha nenet veç e veç.

**Berim Ramosaj** – tha se ne e kemi prolongua javën e kaluar për me sjell detaje më shumë në lidhje më këtë çështje. Ai shtoj se rezervohet për deklaram të mëtutjeshëm dhe kontributin e tij do ta jap në seancë plenare.

**Ethem Çeku** – tha se kemi kërkuar të rishqyrtohet edhe një here dhe nuk ka asgjë politike lidhur më këtë çështje, ku njihërit bëri thirrje që deputetët të jenë të kujdesshëm sepse miratimi i tij ka impakt negativ për shfrytëzimin e resurseve natyrore.

**Berim Ramosaj** – pyeti z.Çeku se ku e sheh impaktin negativ.

**Ethem Çeku** – tha se e para që e kundërshton është se nuk ka analiza të hollësishme, dhe e dyta është se e hjek nga prioriteti Projektin “Kosova e Re” dhe e vendos në pozitë të dytë d.m.th pas gazit. Ai shtoj se duke marr parasysh këto fakte, defaktorizohet resursi jonë thëngjilli dhe limiti, dhe faktorizohet gazi që nuk është prodhim i yni dhe nuk menaxhohet nga vendi ynë. Këtë deklaram e bëri gjithnjë duke u thirr në përvojën e tij si ish ministër dhe njohës i zhvillimeve rajonale.

**Safete Hadergjonaj** – theksoj se nuk sheh arsye që Komisioni më prolongua këtë Projektligj, gjithnjë u thirr në rrethana tjera, gjegjësisht në shtetësi. Ajo shtoj se edhe pse miratohet në parim Projektligji nuk do të thotë se këtu përfundoj krejt puna sepse Komisionin e pret një punë e madhe gjatë amendamentimit të tij pastaj.

**Fatmir Rexhepi** – tha se ne duhet ti japim përparësi politikës strategjike që njëherë është miratuar në Qeveri, dhe t’ia japim shansin kësaj strategjie me rezultatet e saja dhe bëri thirrje mos të komplikohet situata panevoj. Ai shtoj në fund se duhet të aprovohet ky Projektligj, mirëpo jo tani, por në fund të vitit.

**Haki Shatri** – theksoj se i takon deputetëve të thuhet ajo që duhet më u than në Komision, duke shtuar se edhe pse nuk kishte vërejtje në parim në punën e hartuesit përveç në disa nene ku për të cilat, ai theksoj se janë rrezikuar vetë çështje kurrizore të Projektligjit. Ai poashtu tha se edhe vet hartuesi e ka vërejt se nëse disa nene të Projektligjit aplikohen atëherë vjen në kundërshtim më prioritetet e qeverisë. Pas informacionit se ky Projektligj është vendos në rend dite për seancë plenare, ai propozoj që në seancë plenare të hiqet nga rendi i ditës.

Pas diskutimit të gjerë, Komisioni më 4 (katër) Për, 3 (tri) Kundër dhe 1 (një) Apstenim, nxori këtë:

### **Përfundim**

- I. Miratohet në parim Projektligji për Gazin Natyror;
- II. Caktohet Myzejene Selmani si raportuese;

### **V. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve;**

**Kryetarja** - kërkoi nga anëtarët e Komisionit t'i japin komentet e tyre në parim, në lidhje me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve;

**Berim Ramosaj** – theksoj se pas shiqimit të këtij Projektligje ka hasur në disa mangësi, mirëpo shtoj se mund të miratohet në parim dhe pastaj në fazën e amendamentimit do të eliminohen këto mangësi.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni njëzëri e nxori këtë:

### **Përfundim**

- I. Shtyhet miratimi në parim i Projektligjit për Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2004/17 për Mbrojtjen e Konsumatorëve;
- II. Caktohet Berim Ramosaj si raportues.

### **VI. Të ndryshme;**

#### **VI.a) Ligji për Shpronësimin;**

**Kryetarja** – kërkoi nga eksperti i USAID –it, informacion lidhur më këtë çështje.

**Haxhi Gashi (USAID)** – theksoj se brenda kësaj jave do të jetë gati versioni i fundit, pastaj para Grupit punues mund të prezantohet Ligji kur të jetë gati ky Grup punues.

#### **VI.b) Projektligji për Masat Antidamping;**

**Kryetarja** – poashtu kërkoi nga eksperti i USAID –it, informacion lidhur edhe më këtë Projektligj.

**Haxhi Gashi** – theksoj se pas konsultimeve më ekspertët e USAID-it, kemi ardh në përfundim se ky Projektligj nuk i duhet Kosovës, dhe nuk do të ishte e favorshme nëse do të miratohej.

#### **VI.c) Çështjet vijuese**

**Kryetarja** – Propozoi që në mbledhjen e ardhshme të ftohet ministri i Tregtisë dhe Industrisë z.Zharku, për të dhenë shpjegime para Komisionit për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s.

**Berim Ramosaj** – poashtu kërkoj që MTI-ja duhet të deklarohet edhe për zbatimin e Ligjit për Tregti me Naftë dhe Derivate të Naftës.

Pas diskutimit të gjerë, Komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

- I. Ftohet në mbledhjen e radhës më datë 03.02.2009, z.Lutfi Zharku, ministër i Tregtisë dhe Industrisë;
- II. Ministri ftohet për pikën e rendit të ditës ku do të diskutohet për: zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s, dhe respektimin e standardeve në zbatim të akteve për tregti me naftë dhe derivate të naftës;

Mbledhja përfundoi në orën 12:15.

Kryetare e Komisionit

---

Myzejene Selmani